

HEWLETT PACKARD I.T. BV
Dega në Shqipëri

Pasqyrat Financiare të Audituar

Për periudhën e mbyllur më 31 Dhjetor 2013

PËRMBAJTJA:

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	1
PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE	2
PASQYRA E FLUKSEVE TË PARASË	3
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	4
1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM	5
2. POLITIKAT KONTABËL	5
2.1 BAZAT E PËRGATITJES	5
2.2 PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL	5
2.3 NDRYSHIMET NË POLITIKAT KONTABËL DHE SHËNIMET SHPJEGUESE	9
3. PËRDORIMI I VLERËSIMEVE DHE GJYKIMEVE	10
4. STANDARTET DHE INTERPRETIMET E REJA TË PAZBATUARA	10
5. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR	13
6. SISTEMI KONTABËL	14
7. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE	15
8. INVENTARI	15
9. TË ARKËTUESHME NGA KLIENTËT	16
10. TË ARKËTUESHME NGA PALËT E LIDHURA	16
11. TË TJERA TË ARKËTUESHME	16
12. MJETE MONETARE	17
13. TË ARDHURA TË SHTYRA	17
14. TË TJERA DETYRIME AFATGJATA	18
15. TË PAGUESHME NDAJ FURNITORËVE	18
16. TË PAGUESHME NDAJ PALËVE TË LIDHURA	18
17. DETYRIME TATIMORE	19
18. SHITJE MALLRASH	19
19. SHITJE SHËRBIMI	19
20. KOSTO MATERIALESH	19
21. SHPENZIME ADMINISTRATIVE	20
22. KOSTO PERSONELI	20
23. HUMBJE NETO PREJ NDRYSHIMIT TË KURSIT TË KËMBIMIT	20
24. SHPENZIMI I TATIM FITIMIT	21
25. ANGAZHIME DHE DETYRIME TË MUNDSHME	21
26. NGJARJE PAS MBYLLJES SË BILANCIT	21
27. MANAXHIMI I RISKUT FINANCIAR	22

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR TË "HEWLETT PACKARD I.T. BV" – Dega në Shqipëri

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të shoqërisë "HEWLETT PACKARD I.T. BV" Dega në Shqipëri (më poshtë "Dega"), që përmbajnë pasqyrën e pozicionit financiar më datë 31 Dhjetor 2013, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërshirëse për këtë vit ushtrimor, pasqyrën e fluksit të parasë, pasqyrën e ndryshimeve në kapital, dhe një përmbledhje të politikave kontabile dhe të tjera shënime sqaruese.

Përgjegjësitë e Drejtimit për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, dhe për ato kontrole të brendshme, të cilat drejtimi i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare që janë pa gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose të gabimeve.

Përgjegjësitë e Audituesit të Pavarur

Përgjegjësia jone është të shprehim një opinion për pasqyrat financiare duke u bazuar në auditimin e kryer. Ne kryem auditimin tonë në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të përmbushim kërkesat e etikës dhe të planifikojmë dhe kryejmë auditimin me qellim që të përfitojmë një siguri të mjaftueshme që pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për sigurimin e të dhënave të auditimit për shumat dhe deklarimet në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura janë në gjykimin e audituesit, duke përfshirë vlerësimin e rrezikut të keq-deklarimeve materiale, qoftë si rezultat i mashtrimeve apo gabimeve. Gjatë vlerësimit të këtyre rreziqeve, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare të shoqërisë në mënyrë që të përcaktojë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat financiare, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinionit për efektivitetin e kontrollit të brendshëm të shoqërisë. Një auditim gjithashtu përfshin vlerësimin e përshtatshmërisë së parimeve të kontabilitetit të përdorura dhe pranueshmërinë e çmuarjeve kontabile të kryera nga drejtimi, si edhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se të dhënat e auditimit që ne kemi siguruar janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të bazuar opinionin tonë.

Opinion

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare të Shoqërisë japin një pamje të vërtetë dhe të sinqertë të gjendjes financiare të Shoqërisë më 31 Dhjetor 2013 si dhe të rezultateve të aktivitetit të saj për ushtrimin e mbyllur më këtë datë në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Ernst & Young Certified Auditors Shpk,
Skopje-Tirana Branch

Mario Vangjeli
Ekspert Kontabël i Regjistruar



22 Prill 2014
Tiranë, Albania

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR
më 31 Dhjetor, 2013

Shënime	31 Dhjetor 2013 në LEK	31 Dhjetor 2012 në LEK
Aktivet		
Aktive afatgjata		
Aktive afatgjata materiale	7,357	9,809
	7,357	9,809
Aktive afatshkurtra		
Inventari	36,574,639	44,911,868
Të arkëtueshme nga klientët	6,724,828	26,420,653
Të arkëtueshme nga palët e lidhura	5,464,346	25,179,412
Të tjera të arkëtueshme	7,916,854	5,502,408
Mjete monetare	187,446,471	158,831,545
	244,127,138	260,845,886
Totali aktiveve	244,134,495	260,855,695
Kapitali dhe pasivet		
Kapitali		
Fitimet e pashpërndara	166,015,748	135,280,412
Fitim i vitit financiar	21,257,160	30,735,336
Total kapitali	187,272,908	166,015,748
Pasive afatgjata		
Të ardhura të shtyra	35,692,795	41,806,555
Te tjera detyrime afatgjata	3,975,590	4,130,325
	39,668,385	45,936,880
Pasive afatshkurtra		
Të pagueshme ndaj furnitorëve	7,223,152	9,644,309
Të pagueshme ndaj Palëve të lidhura	8,345,053	38,833,773
Të pagueshme të tjera	74,911	-
Detyrime tatimore	1,550,086	424,985
	17,193,202	48,903,067
Totali pasiveve	56,861,587	94,839,947
Totali kapitalit dhe pasiveve	244,134,495	260,855,695

Pasqyrat financiare nga faqja 1 to 21 u firmosën dhe u aprovuan më 28 Mars 2014 prej:

Lukas Najman
Administrator



Irida Jaho
Financiere

Shënimet shpjeguese përbëjnë një pjesë të pandarë të këtyre pasqyrave financiare.

HEWLETT PACKARD I.T. BV – Dega në Shqipëri

PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE
për ushtrimin e mbyllur më 31 Dhjetor, 2013

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013 në LEK	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2012 në LEK
Aktiviteti i vazhdueshëm			
Shitje mallrash	18	11,080,928	10,895,656
Shitje shërbimi	19	78,597,160	77,009,879
Të ardhura		89,678,088	87,905,535
Kosto materialesh	20	(19,856,356)	(17,234,746)
Fitimi bruto		69,821,732	70,670,789
Të ardhura të tjera		872,048	-
Shpenzime administrative	21	(33,829,600)	(32,666,297)
Kosto personeli	22	(7,111,484)	-
Shpenzime amortizimi		(2,452)	(3,270)
Fitimi operativ		29,750,244	38,001,222
Kosto financiare		(279,377)	(106,772)
Humbje prej ndryshimit të kursit të këmbimit, neto	23	(5,908,738)	(2,233,010)
Fitimi përpara tatimit prej aktivitetit të vazhdueshëm		23,562,129	35,661,440
Shpenzim tatim fitimi	24	(3,837,858)	(5,486,685)
E ardhur tatimore e shtyrë	11	1,532,889	560,581
Fitimi i vitit prej aktivitetit të vazhdueshëm		21,257,160	30,735,336

Shënimet shpjeguese përbëjnë një pjesë të pandarë të këtyre pasqyrave financiare.

HEWLETT PACKARD I.T. BV – Dega në ShqipëriPASQYRA E FLUKSEVE TË PARASË
për ushtrimin e mbyllur më 31 Dhjetor, 2013

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013 në LEK	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2012 në LEK
Fluksi i parasë nga aktiviteti i shfrytëzimit		
Fitimi përpara tatimit	23,562,129	35,661,440
Rregullime për:		
Amortizimi	2,452	3,270
Humbje nga kursi i këmbimit	5,908,738	2,233,010
(Zvogëlim)/Rritje e të arkëtueshmeve	30,169,250	(50,878,209)
(Zvogëlim)/Rritje e inventarit	8,337,229	(8,513,176)
(Zvogëlim)/Rritje e të pagueshmeve	(36,812,100)	37,455,490
Mjete monetare të përfituara nga aktiviteti i shfrytëzimit	31,167,698	15,961,825
Interesi i paguar	-	-
Tatim fitim i paguar	4,115,016	6,801,090
Mjete monetare neto të përfituara nga aktiviteti i shfrytëzimit	35,282,714	22,762,915
Fluksi i parasë nga aktiviteti investues		
Blerje e aktiveve afatgjata materiale	-	-
Mjete monetare nga shitja e aktiveve afatgjata	-	-
Mjete monetare neto nga aktiviteti investues	-	-
Fluksi i parasë nga aktivitetet financuese		
Mjete monetare nga hua afatgjatë	-	-
Pagesa të detyrimeve qiramarrëse	-	-
Dividentë të paguar	-	-
Mjete monetare neto nga aktiviteti financues	-	-
Rritja neto e mjeteve monetare	35,282,714	22,762,915
Mjetet monetare më 1 Janar	158,831,545	138,109,378
Ndryshimi nga kursi i këmbimit	(6,667,788)	(2,040,748)
Mjetet monetare më 31 Dhjetor	187,446,471	158,831,545

Shënimet shpjeguese përbëjnë një pjesë të pandarë të këtyre pasqyrave financiare.

HEWLETT PACKARD I.T. BV – Dega në Shqipëri

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL
për ushtrimin e mbyllur më 31 Dhjetor, 2013

	Fitimet e pashpërndara në LEK	Totali kapitalit në LEK
Gjendje më 1 Janar 2012	135,280,412	135,280,412
Fitimi neto për periudhën	30,735,336	30,735,336
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për periudhën	30,735,336	30,735,336
Dividentë të paguar	-	-
Gjendje më 31 Dhjetor 2012	166,015,748	166,015,748
Fitimi neto për periudhën	21,257,160	21,257,160
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për periudhën	21,257,160	21,257,160
Dividentë të paguar	-	-
Gjendje më 31 Dhjetor 2013	187,272,908	187,272,908

Shënimet shpjeguese përbëjnë një pjesë të pandarë të këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

Hewlett-Packard I.T. BV Dega e Shqiperise eshte Dege e Hewlett-Packard International Trade B.V., shoqeri e regjistruar ne Dhomen e Tregtise te Amsterdami, Hollande. Dega eshte regjistruar ne Shqiperi me vendim te Gjykates se rrethit Tirane me numer te regjistrimit tregtar Nr.36386 dhe date 24 Tetor 2006.

Aktiviteti kryesor i Deges eshte tregtimi i mallrave te Teknologjise Informatike, sherbime qe lidhen me keto mallra, asistence teknike si dhe sherbime mirembajtjeje. Administrator i deges eshte Z. Lukas Najman.

Ne 31 Dhjetor 2013 Dega ka 1 (nje) punonjes (31 Dhjetor 2012: 0 punonjes). Zyra e regjistruar ndodhet ne Rruga “Ibrahim Rugova” Green park, Kulla 1, Tirane. Dega eshte e regjistruar si person juridik ne rrethin e Tiranës me NIPT K62405008G.

Pasqyrat financiare te Deges per ushtrimin e mbyllur me 31 Dhjetor 2013 jane miratuar nga Administratori i deges me 28 Mars 2014.

2. Politikat kontabël

2.1 Bazat e përgatitjes

Pasqyrat Financiare jane pergatitur te gjithe aspektet materiale, ne perputhje me ligjin Nr 9228 date 29 Prill 2004 “Mbi Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, me Standardet Nderkombetare te Raportimit Financiar (SNRF) te perkthyer pa ndryshime nga origjinali ne gjuhen Angleze dhe te aprovuara per perdorim nga Keshilli Kombetar i Kontabilitetit (KKK) me vendimin nr.1 date 19.04.08 dhe urdher te Minisitrit te Financave nr. 65 date 05.05.2008 per publikimin dhe implementimin e SNRF te aprovuara nga KKK.

Te dhenat jane paraqitur ne Lek (LEK), qe eshte edhe monedha funksionale e Deges.

Pasqyrat Financiare jane pergatitur duke u bazuar ne koston historike, perjashtuar derivativet financiar (n.q.s ka), instrumentat financiare me vlere te drejte permes fitimit e humbjes dhe aktivet financiare te vlefshme per shitje, te cilat maten me vlere te drejte.

2.2 Përmbledhje e politikave kontabël

a. Transaksionet në valutë të huaj

Pasqyrat financiare te Deges jane paraqitur ne Lek. Dega ka percaktuar monedhen e saj funksionale dhe zerat e pasqyrave financiare jane matur duke perdorur kete monedhe.

(i) Transaksionet dhe balancat

Transaksionet ne monedhen e huaj regjistrohen fillimisht nga Dega me kurset e kembimit funksionale ditore respektive ne daten me te pare qe njihet transaksioni. Aktivet dhe detyrimet monetare te emeruara ne monedhe te huaj konvertohen perseri me kursin e kembimit funksional ne daten e raportimit. Te gjitha diferencat qe vijne prej mbylljes ose konvertimit te zerave monetare reflektohen ne pasqyren e te ardhurave.

2.2 Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

a. Transaksionet në valutë të huaj (vazhdim)

(i) Transaksionet dhe balancat (vazhdim)

Zerat jomonetare të cilat perlllogariten me kosto historike në monedhe të huaj, konvertohen duke përdorur kurset e kembimit të datave të transaksionit fillestar. Zerat jomonetare të cilat njihen me vlerën e drejte, në monedhe të huaj, konvertohen duke përdorur kurset e kembimit në datën kur percaktohet vlera e drejte. Humbja ose fitimi që del nga konvertimi i zerave jomonetare trajtohet në të njëjtën mënyrë si njohja e humbjes ose fitimit nga ndryshimi i vlerës së drejte të zerave të bilancit (psh konvertimi i diferencave në zera të cilave u njihet humbja ose fitimi në pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse, respektivisht)

	<u>31 Dhjetor 2013</u>	<u>31 Dhjetor 2012</u>
1 EUR	140.20	139.59
1 USD	101.86	105.85

b. Njohja e të ardhurave

Te ardhurat njihen me vlerën e përfitimeve të ardhshme ekonomike që do të hyjnë në Dege dhe këto përfitime mund të maten konkretisht pavaresisht se kur kryhen pagesat. Kostot njihen në pasqyrën e të ardhurave kur ndodhin (dhe jo domosdoshmerisht kur janë bërë pagesat). Te ardhurat dhe kostot regjistrohen në pasqyrat financiare të periudhës të ciles i perkasin.

c. Tatimi mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit fitimit perbehet nga tatimi aktual dhe tatimi i shtyre. Tatimi aktual dhe tatimi i shtyre njihen në humbje ose fitim përveç se kur ajo lidhet me zerat të cilat njihen direkt në kapital ose në të ardhura të tjera gjithpërfshirëse.

Tatimi fitimi aktual

Tatimi aktual është perlllogaritje e tatimit fitimit pagueshem mbi të ardhurat e tatueshme për vitin, duke përdorur norma të takses në fuqi në datën e raportimit, dhe ndonjë sistemim në pagesat e tatimeve në lidhje me vitet e kaluara.

Aktivitet dhe pasivitet tatimore për këto periudha perlllogariten në vlerën e pritshme që do të kompensohet ose do t'i paguhet autoriteteve tatimore. Norma tatimore dhe legjislati i tatimit i përdorur për të llogaritur vlerat janë ato nga të cilat janë në fuqi, në datën e raportimit në Shqipëri.

Tatimi fitimi aktual lidhet me zera të cilat njihen direkt në kapital njihet në kapital dhe jo në pasqyrën e të ardhurave. Menaxhimi në mënyrë periodike vlerëson pozicionin e mbajtur në kthimet tatimore sipas situatave në të cilat rregulloret e tatimit të aplikueshem janë subjekt i interpretimeve dhe vendos provigjione aty ku është e pershtatshme.

Tatimi mbi fitimin i shtyre

Tatimi i shtyre rrjedh nga përdorimi i metodës së detyrimeve mbi diferenca të perkohshme midis bazës së tatueshme të aktiveve dhe pasiveve, dhe pagesave të tyre për qellime të raportimit financiar në datën e raportimit.

2.2 Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

c. Tatimi mbi fitimin (vazhdim)

Detyrimet e tatimit të shtyre njihen për të gjitha diferencat e perkohshme të tatueshme, përveç:

- Kur detyrimi i tatimit të shtyre del nga njohja fillestare e emrit të mirë ose një aktivi ose një detyrimi në një transaksion që nuk është kombinim operacional dhe, në kohën e transaksionit, nuk ndikon as fitimin kontabel as fitimin ose humbjen e tatueshme.
- Në lidhje me diferencat e perkohshme të tatueshme të lidhura me investime në filiale, shoqëri dhe interesa në sipërmarrje të përbashkëta, kur koha e ndryshimit të diferencave të perkohshme mund të kontrollohet dhe është e mundur që këto diferencat të mos kthehen në periudha të ardhshme.

Vlera kontabel e aktiveve tatimore të shtyra rishikohet në çdo datë raportimi dhe reduktohet deri në atë vlerë që nuk është më e mundur që fitimi i tatueshem do të jetë i mjaftueshem të jetë disponibel për të lejuar teresisht ose pjesërisht përdorimin e tatimit të shtyre. Aktivet tatimore të panjohura rivelesohen në çdo datë raportimi dhe njihen deri në atë vlerë që do të jetë e mundur për të mbuluar aktivet tatimore të shtyra në fitimet e tatueshme të viteve të ardhshme.

Aktivitet dhe pasivitet tatimore të shtyra përlogariten sipas normës tatimore që pritet të aplikohet në vitin kur realizohet aktivi ose përcaktohet detyrimi, bazuar në normat tatimore (ose legjislativën tatimore) që është në fuqi në datën e raportimit.

Tatimi i shtyre që lidhet me zërat të cilat njihen jashtë fitimit ose humbjes do të njihet jashtë fitimit ose humbjes. Zërat e tatimit të shtyre njihen për transaksionet përkatëse ardhurat gjithëpërfshirë ose direkt në kapital.

Aktivitet dhe pasivitet tatimore të shtyra kompensohen nëse ekziston një e drejtë e zbatueshme juridike për të kompensuar aktivitet e tatueshme kundrejt detyrimeve të tatimit aktual dhe tatimi i shtyre kundrejt të njëjtit subjekt të tatueshem dhe të njëjtit autoritet tatimor.

d. Aktivitet afatgjatë materiale dhe jomateriale

Njohja dhe matja

Zërat e aktiveve afatgjatë materiale përlogariten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe zhvleresimin e akumuluar.

Kostot përfshijnë shpenzimet që lidhen drejtperdrejtë me blerjen e një aktivi. Kur pjesë të një zëri të aktiveve afatgjatë materiale kanë jete të dobishme të ndryshme, ato kontabilizohen veçmas si aktive afatgjatë materiale. Fitimi dhe humbja nga pakesimi i një zëri të aktiveve afatgjatë materiale përcaktohet duke krahasuar të ardhurat nga shitja me vlerën kontabel të aktiveve afatgjatë materiale, dhe njihen me vlerën neto tek të ardhurat e tjera në pasqyrën e të ardhurave.

Kostot vijuese

Kosto për zëvendësimin e një pjesë të një zëri të aktiveve afatgjatë materiale njihet me vlerën kontabel të zërit nëse është e mundur që përfitime të ardhshme ekonomike do të hyjnë në Dege, dhe kostot e saj mund të maten konkretisht. Vlera kontabel e pjesës së zëvendësuar nuk njihet. Kostot e mirembajtjes së përditshme të aktiveve afatgjatë materiale njihen në pasqyrën e të ardhurave kur ndodhin. Kur pjesë të rëndësishme të aktiveve afatgjatë materiale kërkojnë zëvendësimin me intervale, Dega njihet pjesët e tilla si aktive individuale me jete të dobishme specifike dhe i amortizon ato individualisht. Në të njëjtën mënyrë, kur bëhet një kontroll i përgjithshëm, kostot e tij njihen në vlerën kontabel të aktiveve afatgjatë materiale, si zëvendësim nëse kriteret e njohjes përmbushen. Të gjitha kostot e tjera të riparimeve dhe mirembajtjes njihen në pasqyrën e të ardhurave kur ato ndodhin.

2.2 Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)**d. Aktivet afatgjata materiale dhe jomateriale (vazhdim)****Amortizimi**

Normat vjetore të amortizimit të përdorura, bazuar në Udhezimin e Ministrisë së Financave nr. 5 datë 30 Janar 2006 janë si më poshtë:

Aktivet Materiale	Norma e Zhvleresimit %		Baza e perlllogaritjes
	2013	2012	
Makineri e Pajisje	20	20	Mbi vlerën e mbetur
Materiale Zyre	20	20	
Pajisje elektronike	25	25	

Vlera e mbetur e asetëve, jeta e dobishme dhe metodat e amortizimit rishikohen çdo vit financiar dhe rregullohen prospektivisht, nëse është e pershtatshme.

Aktivët jomateriale njihen nëse parashikohet që Dega të ketë përfitime të ardhshme ekonomike që kanë lidhje me këto aktive dhe kosto e aktivit mund të matet në mënyrë të besueshme.

e. Inventari

Inventari është vlerësuar me vlerën më të ulët midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Kostot për të sjellë inventarin në gjendjen dhe vendin përkatës janë kontabilizuar në baze të faturave të blerjes kurse shpenzimet e përgjithshme të lidhura me inventarin janë shpërndarë duke përdorur mesataren e ponderuar.

Vlera neto e realizueshme përcaktohet nga cmimi shitjes minus kostot e parashikuara për të shitur inventarin.

f. Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre përfshijnë paratë në dorë dhe para të depozituara në banke, investime aftashkurtra likuide, me maturitet tre muaj ose më pak, vlera e drejte e të cilave nuk ndryshon shumë dhe menaxhohen nga Dega në likuidimin e angazhimeve afatshkurtra.

g. Llogari, kërkesa të arkëtueshme dhe të pagueshme ndaj furnitorëve

Kliente të furnitorëve paraqiten në bilanc me vlerën e fatures origjinale dërguar klientit ose marrë nga furnitori minus provizionin e lidhur me to. Provizione për borxhe të keqja behen kur konsiderohet që vlerat e kërkueshme nuk mund të shlyhen. Provizioni për borxhin e keq është vlera e llogaritur nga drejtuesit për të qenë e mjaftueshme të mbulojë humbjet e mundshme nga kërkesat për arketim ekzistuese që mund të behen të paarkëtueshme si pasoje të gjendjes ekonomike, cilesisë dhe rrezikut të klientëve si edhe faktoreve të tjera të lidhura me to, të cilat kërkojnë vlerësim të menjehershëm.

Shuma e provizionit është diferenca midis vlerës kontabel dhe shumës së rikuperueshme, e cila është vlera aktuale e flukseve të ardhshme minus normën e interesit të tregut për huamarrje të ngjashme.

2.2 Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

h. Benefite pas largimit nga puna dhe skema pensionesh

Dega paguan kontributet për pensione si edhe kontribute për sigurim shëndetësor për punonjësit e saj siç është parashikuar nga legjislacioni lokal mbi sigurimet shoqërore. Kontributet, bazuar në pagat, janë paguar në llogari të organizmave kombëtare përgjegjëse për pagesën e pensioneve dhe shpenzimeve shëndetësore. Nuk ka detyrime të tjetra shtese në lidhje me fondin për pensione.

i. Zëra jashtë bilancit

Zerat e rregjistruara jashtë bilancit reflektojnë kontrata (pa transferime parash) mes Degës dhe institucioneve financiare. Me se shumti të tilla zotime lidhen me zotime financiare ose garanci. Ato përfaqësojnë një detyrim bankar për të bërë dëkë gjatë ose brenda një periudhe të caktuar kohore. Këto zotime regjistrohen kur detyrimi lind. Shuma për t'u rregjistruar jashtë bilancit përputhet me shumën e garantuar ose me shumën e zotuar të cilesuar në kontratë. Në datën e maturimit regjistrimi kthehet mbrapsht.

2.3 Ndryshimet në politikat kontabël dhe shënimet shpjeguese

Standarte të reja dhe të rishikuara

Politika kontabel janë zbatuar në vijimësi me politikat kontabel të zbatuara vitin paraardhës përveç për SNK-te me poshtë që janë zbatuar nga Dega që në datë 01 January 2013.

- **SNK 1 Paraqitja e Pasqyrave Financiare (Amenduar) - Paraqitja e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse.**
- **SNK 19 Benefitet e punonjësve (Rishikuar)**
- **SNRF 7 Instrumentet financiare: Paraqitja me vlerën neto të Aseteve Financiare dhe Detyrimeve Financiare**
- **SNRF 13 Matja me vlerën e drejte**
- **KIRFN 20 “Shpenzimet e nxjerrjes në fazën e prodhimit të një sipërfaqje miniere”**
- **Permirsimet vjetore të SNRF-ve 2009-2011**

Pershtatja me standartet dhe interpretimet përkruhet me poshtë.

- **SNK 1 Paraqitja e pasqyrave financiare (e rishikuar) – Paraqitja e Zërave të të Ardhurave të Tjera Gjithëpërfshirëse**
Rishikimet e SNK 1 ndryshojnë mënyrën e grupimit të zërave që paraqiten tek Të Ardhurat Gjithëpërfshirëse. Zërat që mund të riklasifikohen (apo “riciklohen”) nëpërmjet pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve në një të ardhme (për shembull, fitimi neto në mbrojtje të investimeve neto, diferencat nga kurset e kembimit, levizjet neto të flukseve monetare mbrojtëse dhe humbja ose fitimi neto të aktiveve të vlefshme për shitje) do paraqiten të ndara nga ato zëra të cilat nuk do riklasifikohen kurrë (për shembull, humbjet dhe fitimet aktuariale nga skemat me përfitime të përcaktuara dhe në rivlerësimin e tokës dhe ndertesave). Rishikimi ka vetëm efekte në dhënien e informacionit shpjegues dhe nuk ka ndikim në pasqyrën apo performancën financiare të Degës. Aplikimi i rishikimeve të mesiperme nuk do të ketë impakt në pasqyrat financiare të Degës.

**2.3 Ndryshimet në politikat kontabël dhe shënime shpjeguese (vazhdim)
Standarte të reja dhe të rishikuara (vazhdim)**

• **SNRF 7 Instrumentet Financiare: Dhënia e informacioneve shpjeguese (e rishikuar) - Shuarja e Aktiveve dhe Detyrimeve Financiare**

Këto rishikime kërkon dhënien e informacioneve shpjeguese për mosnjohjen e aktiveve financiare dhe marrëveshjeve të lidhura (p.sh,marrëveshjet me kolateral). Këto shënime shpjeguese do t'u ofrojnë përdoruesve informacion që është i dobishëm në vlerësimin e efektit apo efektit të mundshëm të marrëveshjeve neto, mbi pozicionin financiar të njësisë ekonomike. Shënime të reja shpjeguese duhet të zbatohen për të gjitha instrumentat financiarë që janë jashtë përkufizimit të SNK 32: Paraqitja. Dhënia e informacioneve shpjeguese duhet të zbatohet për të gjitha instrumentat financiarë që janë subjekt i marrëveshjeve kompensimi të brendshme ose marrëveshjeve të ngjashme, edhe pse nuk kualifikohen për kompensim në përputhje me SNK 32. Aplikimi i rishikimeve nuk do të ketë impakt në pasqyrat financiare të Degës.

• **SNRF 13 Matja me vlerën e drejtë**

SNRF 13 krijon një burim të vetëm udhëzimesh sipas SNRF për të gjitha matjet e vlerës së drejtë. SNRF 13 nuk ndryshon kur një njësi ekonomike është e nevojshme të përdori vlerën e drejtë, por jep udhëzime se si të masësh vlerën e drejtë sipas SNRF kur vlera e drejtë është e nevojshme ose lejohet. Aplikimi i SNRF 13 nuk ka ndikuar materialisht në matjet me vlerën e drejtë të kryera nga Dega. SNRF 13 gjithashtu kërkon shënime shpjeguese të vecanta mbi vlerën e drejtë, disa prej të cilave zëvendësojnë shënime shpjeguese aktuale të kërkuara nga standarte të tjera, duke përfshirë SNRF 7 Instrumentat financiarë: Dhënia e shënimeve shpjeguese. Aplikimi i këtij standardi nuk do të ketë impakt në pasqyrat financiare të Degës.

3. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Paraqitja e Pasqyrave Financiare konform SNRF-ve, kërkon që manaxhimi të bëjë vlerësime, gjykime e supozime që ndikojnë në aplikimin e politikave kontabel dhe vlerën e raportuar të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave e shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen vazhdimisht. Rishikimet e vlerësimeve kontabel njihen në periudhën kur ndodh rishikimi dhe në çdo periudhë të ardhme që preket.

Informacioni rreth fushave kryesore të vlerësimeve të pasigurta dhe gjykimeve kritike gjatë zbatimit të politikave kontabel, që kanë efekt të rëndësishëm në shumat e paraqitura në Pasqyrat Financiare, paraqitet në shënime të vazhdim.

4. Standartet dhe interpretimet e reja të pazbatuara

Një numër standartesh të reja, amendamente të standardeve dhe interpretime janë efektive gjatë fillimit të periudhës 1 Janar 2012, dhe nuk janë zbatuar në pasqyrat financiare vjetore aktuale.

- **SNK 28 “Investimet në pjesëmarrje dhe Join Venture”(Amenduar)-** (efektive për periudhë vjetore më dhe pas 1 Janar 2014)

4. Standartet dhe interpretimet e reja të pazbatuara (vazhdim)

- **SNK 32 “Instrumentet Financiarë: Paraqitja” (Amenduar)-kompesimi (paraqitja neto) i aktive financiare me pasivet financiare,**(efektive për periudha vjetore më dhe 1 Janar 2014)
- **SNRF 9 “Instrumentet Financiarë” Klasifikimi matja dhe amendime te mevonshme te SNRF 9 dhe te SNRF 7- Data efektive e zbatimit dhe shpjegimet per ndryshimet; Kontabiliteti gjate per ndryshimet dhe amendimet ne SNRF 9, SNRF 7, dhe SNK 39** (nuk eshte percaktuar ende data efektive e hyrjes ne zbatim)
- **SNRF 10 “Pasqyrat financiare te konsoliduara, SNK 27 Pasqyrat financiare individuale,** (efektive për periudha vjetore më 1 Janar 2014).
- **SNRF 11 “Marveshjet e perbashketa”** (efektive për periudha vjetore duke filluar më 1 Janar 2014).
- **SNRF 12 “Dhënia e informacioneve shpjeguese në lidhje me interesat në njësitë e tjera ekonomike”** (efektive për periudha vjetore më dhe 1 Janar 2014).
- **Udhëzimi per ndryshimin (Amendimi i SNRF 10, SNRF 11 dhe SNRF 12)** (efektive për periudha vjetore më 1 Janar 2014).
- **Njesite ekonomike te Investimeve (Amendime te SNRF 10, SNRF 12 dhe SNK 27)** (efektive për periudha vjetore duke filluar më 1 Janar 2014).
- **SNK 36 “Zhvleresimi i aktiveve (Amenduar) - Vlera e rikuperueshme per asetet jo-financiare** (efektive për periudha vjetore duke filluar më 1 Janar 2014).
- **SNK 39 “Instrumentet Financiare”;(Amenduar) Njohja dhe matja – Novacioni ne titujve derivative vijimesia gjate periudhave kalimtare** (efektive për periudha vjetore duke filluar më 1 Janar 2014).
- **SNK 19 “Planet e perfitimeve (Amenduar); Perfitimet e punonjsve** (efektive për periudha vjetore duke filluar më 1 Janar 2014).
- **KIRFN Interpretimi 21: Taksat** (efektive për periudha vjetore duke filluar më 1 Janar 2014).

Përmirësime vjetore Maj 2012

Bordi i SNK ka emetuar Përmirësime vjetore të SNRFve për vitet 2009-2011, të cilat përmbajnë amendamente të standarteve dhe lidhura me bazën aktuale për përfundime. Projektet për përmirësimet vjetore shfaqin një mekanizëm për t'i bërë amendamentet të SNRFve të nevojshme, por jo te detyrueshme menjehere. Data efektive e amendamenteve të SNRF-ve është në fillim dhe më pas të periudhës 1 Janar 2013. Ky projekt nuk është aprovuar ende në Europë. Shoqëria është në procese vlerësimit të impaktit të këtij projekti në pozicionin financiar dhe në performancën e saj.

- **SNK 1 Paraqitje e pasqyrave financiare.** Këto përmirësime sqarojnë diferencën midis informacionit për krahasueshmërinë i paraqitur vullnetarisht dhe minimumit të kërkuar. Në përgjithësi, minimum i kërkuar për krahasimin e periudhës është me atë të periudhës së mëparshme.
